

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" RIAN COMPANY" SHPK

Sot me daten 09/09/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

- **I Z. FISNIK TURRA**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 30 Dhjetor 1994, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J41230081F.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " RIAN COMPANY" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " RIAN COMPANY" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Tirane Kavaje KAVAJE Lagjja 6, Rruga Skuraj, Banese Private Nr.6

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË


Shërbime marketingu. Reklama në Rrjetet Sociale, menaxhim faqesh Facebook, Instagram. Menaxhim kanalesh Youtube. Komisioner për ndërmjetësime të ndryshme tregtare, për lidhje kontratash. Agjensi Imobiliare.Gjenerim database.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " RIAN COMPANY" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:



1. FISNIK TURRA zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë

- 1- **Z. FISNIK TURRA**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tirëanë për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"RIAN COMPANY" SH.P.K
FISNIK TURRA

Fisnik Turra

